

Punim Diplome Master

Bajram KABASHI

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
”HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIM DIPLOME – MASTER

**ANALIZA DALLUESE NË DISA HAPSIRA ANTROPOMETRIKE DHE
MOTORIKE NDËRMJET NXËNËSVE DHE FUTBOLLISTËVE TË
RINJË TË GRUPMOSHËS 12-13 VJEÇ**

Mentori:

Dr.Sc.BYLBYL SOKOLI

Kandidati:

BAJRAM KABASHI

PRISHTINË, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
”HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIM DIPLOME - MASTER

**Tema: ANALIZA DALLUESE NË DISA HAPSIRA ANTROPOMETRIKE
DHE MOTORIKE NDËRMJET NXËNËSVE DHE FUTBOLLISTËVE
TË RINJË TË GRUPMOSHËS 12-13 VJEÇ (± 6 MUAJ)**

Mentori:

Dr.Sc.BYLBYL SOKOLI

Kandidati:

BAJRAM KABASHI

PRISHTINË, 2020

Punim Diplome Master

Bajram KABASHI

Abstrakt

Në këtë punim është trajtuar mostra totale prej 173 entiteteve të gjinisë mashkullore të grupmoshës 12 – 13 vjeç (± 6 muaj), të ndara në dy grupe. Në grupin e parë janë përfshirë nxënës të dy shkollave të futbollit: SHF “Liria” dhe SHF “Ballkani”, ndërsa në grupin e dytë janë përfshirë nxënës të dy shkollave fillore të mesme të ulëta: SHFMU “Bajram Curri” dhe SHFMU “Loyola Gymnasium”. Qëllimi i këtij hulumtimi është të vlerësohet gjendja initiale e parametrave antropometrike dhe motorik, të vërehet ndikimi i tretmanit kineziologjik në parametrat antropometrik dhe motorik te të dy grupet që do të testohen si dhe të pasqyrohen dallimet ndërmjet grupeve në hapsirën antropometrike dhe motorike. Në punim janë përfshirë 7 ndryshore antropometrike dhe 7 motorike. Për të përmbushur qëllimin e hulumtimit janë përdorur këto metoda statistikore: parametrat themelor statistikor, korelacionet sipas Pearsonit, T-testi dhe analiza diskriminative. Përpunimi i të dhënave dhe analizimi i tyre mundësoj vërtetimin e hipotezave të parashtruara: H1 Pritet që ndryshoret antropometrike dhe motorike të kenë shpërndarje normale të rezultateve. (Është vërtetuar pjesërisht); H2 Pritet të arrihen ndërlidhje të rëndësishme në të dy nivelet e rëndësisë statistikore në hapsirën antropometrike. (Është vërtetuar pjesërisht); H3 Pritet të arrihen ndërlidhje të rëndësishme në të dy nivelet e rëndësisë statistikore në hapsirën motorike. (Është vërtetuar plotësisht); H4 Supozojmë të ketë dallime të theksuara në parametrat motorike ndërmjet të dy grupeve. (Është vërtetuar pjesërisht).

Ky punim është një tregues për gjendjen momentale të hapësirës antropologjike dhe motorike të të testuarve. Shpresojm gjithashtu t’u shërbej trajnerëve pranë klubeve përkatëse për hartimin e planprogrameve adekuate si dhe për planifikimin e ngarkesave gjatë procesit stërvitor.

Fjalët kyçe: analiza, hapsira antropometrike, motorike, nxënësve, futbollistët.

Abstract

In this paper, we have treated a total sample of 173 entities of the male sex of the age groups 12-13 (+ six months) divided into two groups. In the first group are included students from two football schools: FS "Liria" and FS "Ballkani", while in the second group are included students from junior high school "Bajram Curri" and the junior high school "Loyola Gymnasium". The purpose of this research is the evaluation of the initial anthropometric and motoric parameters, the observation of the effect of the kinesiological treatment on anthropomorphic and motoric parameters. In the paper are included 7 anthropomorphic variables and 7 motoric ones. To fulfill the purpose of this research following statistic methods are used: basic statistic parameters, correlations according to Pearson, T-test and discriminative analysis. Data proceedings and their analysis enabled us the attestation of the displayed hypothesis: H1 is expected for the anthropometric and motoric variables to have a normal distribution of the results. Is has been proven partially. H2 is expected to achieve important interrelation on both levels of the statistic importance in the anthropomorphic space. It has been proven partially. H3 is expected to achieve important interconnection on both levels of the statistic importance in the motoric space. It has been proven completely. H4 we assume of having significant differences in motoric parameters between two groups. It has been proven partially. This paper is an indicator of the present state of the anthropologic and motoric space of the tested students and we also hope this might serve to the coaches of the respective clubs for the drawing of proper curricula and the planning of the assignments during the training process.

Keywords: analysis, anthropomorphic space, motoric, students, footballers.

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	5
1.1	HULUMTIMET E GJERTANISHME.....	8
2.	QËLLIMI I HULUMTIMIT	10
2.1	HIPOTEZAT THEMELORE	11
3.	METODAT E HULUMTIMIT	12
3.1	PËRKUFIZIMI DHE PËRSHKRIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT	12
3.2	PËRKUFIZIMI DHE PËRSHKRIMI I MOSTRËS SË NDRYSHOREVE.....	13
3.2.1	Ndryshoret antropometrike:	13
3.2.2	Ndryshoret motorike:.....	13
3.3	PËRSHKRIMI I TESTËVE ANTROPOMETRIME DHE MOTORIKE.....	14
3.3.1	Matjet e testëve antropometrike.....	14
3.3.2	Matjet e testëve motorike.....	21
4.	METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	28
5.	REZULTATET DHE INTERPRETIMI I TYRE	29
5.1	PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË KLUBEVE	29
5.2	PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS	31
5.3	KORELACIONET NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË KLUBEVE	33
5.4	KORELACIONET NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË KLUBEVE	34
5.5	KROSKORELACIONET NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË KLUBEVE	35
5.6	KORELACIONET NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS	36

5.7 KORELACIONET NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS	37
5.8 KROSKORELACIONET NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS	39
5.9 T-TESTI NDËRMJET GRUPIT TË NXËNËSVE TË KLUBEVE DHE ATYRE TË SHKOLLËS	41
5.10 ANALIZA DISKRIMINATIVE.....	43
6. ANALIZA DHE VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	46
7. PËRFUNDIMI ME REKOMANDIME.....	47
8. LITERATURA.....	51

1. HYRJE

Futbolli si sport-lojë kolektivei cili i takon grupit Kineziologjik polistruktural komplekse, ku si karakteristik themelore e të cilave është sistemi kompleks i lëvizjëve të tipit ciklik dhe aciklik të cilët qëllimin kryesor lëvizor kanë goditjen në cak të caktuar dhe në hapsirë me projekttil të udhëhequr ose të hudhur apo gjuajtur, dhe në të cilën rezultati në parim varet nga bashkpunimi i antarëve të skuadrës.

Si ç’do sport tjetër edhe Futbolli si lojë ka kaluar në evolucionin historik të saj duke pësuar ndryshime të mëdha sasiore dhe cilësore në të gjitha komponentët e lojës, rregullat e lojës¹, ndryshimet infrastrukturore, ndryshimet në metodologjin e stërvitjeve, përgatitjeve psiko-motorike², psiko-sociale, tekniko-taktike³, faktorët morfologjik, ushqimi etj.

Masoviteti i madh dhe me ndikim të theksuar në jetën shoqërore-ekonomike janë stimulues të fuqishëm dhe japin motiv të gjithë profesionistëve që në mënyrë profesionale e shkencore të hulumtojnë rreth kësaj loje.

Modernizimi i shoqërisë së sotme kalon edhe nëpërmjet evolucionit, modifikimit dhe ndryshimit të njeriut. Realizimi i formimit të futbollistit të sotëm kërkon një formim edukativ kompleks që vetëm pak vite më parë as nuk mund të mendohej.

Në këto vitet e fundit sporti në përgjithësi dhe futbolli në veçanti ka marr funksione edukativo-arsimore me qëllim formimin e futbollistëve në mënyrë multidimensionale duke qenë gjithmonë në harmoni me botën fizike dhe sociale në të cilën bën pjesë vetë ai.

Edhe loja e futbollit në funksion të popullaritetit të saj të madh dhe gjithëpërfshirës që ka në botë nuk mund t’i shmanget qëllimit kryesor që ka në detyrat e saj transformuese tek sportistët duke ndikuar shumë në etikën dhe moralin e tyre.

Rëndësi të veçant kësaj loje duhet t’i kushtohet edhe në programet kurrikulare në shkolla, sepse hapi i parë institucional ku talentat vijnë në pah me afinitetet e tyre sportive janë pikërisht institucionet e shkollave konkretisht pedagogëve të edukimit fizik dhe sportiv.

¹ Rregullat e Lojës së Futbollit 2016/2017 (Federata e Futbollit e Kosovës), fq.12-14.

² Nikola Komuçi, Xhani Leali “ Përgatitja Fizike e Futbollistit ” (Federata Shqiptare e Futbollit), fq.4.

³ Xhani Leali “ Futbolli Teknika dhe Taktika “ (Federata Shqiptare e Futbollit), fq.17-18.

Sot më tepër se kurrë kush do që merret me aktivitete rinore në edukimin dhe transformimin e fëmijëve qoftë në shkollë apo në klube sportive duhet të ketë një bazë të mirë të përgatitjes akademike-profesionale jo vetëm të kryer por edhe vazhduar në mënyrë sistematike në programe të ndryshme trajnuese për të qenë gjithmonë e më afër ndryshimeve të reja në metodologjinë stërvitore dhe marrjen e dijeve dhe njohurive të reja si dhe të kenë sens përgjegjësie dhe llogaridhënje në atë çfarë po bëjnë në jetën e përditshme me fëmijët.

Si rrjedhojë përgatitja e trajnerit-pedagogut si profesionist por edhe atij që merret me aktivitete amatore (diletante) duhet të jetë nga një bazë e përshtatshme me detyrën, që do ta kryej në funksion të përdorimit stimulimit sportiv në një këndvështrim real dhe efikas.

Popullariteti i kësaj loje të quajtur futboll, sidomos midis fëmijëve është i lidhur me shumë faktorë:

1. Publiciteti i jashtëzakonshëm nga masmedia.
2. Mundësia për t'u praktikuar kudo.
3. Mundësia që të ofrohet për të shkarkuar energji dhe tensione.
4. Rregulla shumë të thjeshta dhe role dinamike.
5. Përdorimi i topit si mjet apo faktor socializimi.

“ Topi e qon fëmijën të kërkoj tek tjetri shokun e lojës duke ndihmuar kështu në lidhjen e mardhënieve mes tyre”.⁴

⁴ Kabrini Masimo. ”Psikologjia në Futboll”,(Federata Shqiptare e Futbollit),fq.9.

Rëndësia e topit si një instrument edukues:

Në drejtim psikomotorik⁵:

- Të përmirësoj koordinimin dhe organizimin e formës së trurit.

Në drejtim konjektiv⁶:

- Formëson karakterin, zhvillon vetëbesimin dhe kreativitetin.

Në drejtim shoqëror⁷:

- Përmirëson komunikimin dhe mardhëniet ndërs shoqërore.

⁵ Kabrini Masimo.2010 "Psikologjia në Futoll",(Federata Shqiptare e Futbollit),fq.15.

⁶ Kabrini Masimo.2010 "Psikologjia në Futoll",(Federata Shqiptare e Futbollit),fq.15.

⁷ Kabrini Masimo.2010 "Psikologjia në Futoll",(Federata Shqiptare e Futbollit),fq.15.

1.1 HULUMTIMET E GJERTANISHME

Hulumtimet në hapësirën Antropometrike dhe Motorike janë bërë nga hulumtues të ndyshëm si brenda dhe jashtë vendit tonë. Disa nga hulumtimet e bëra në këtë fushë dhe të cilat trajtojnë të njëjtën problematikë do të cekim të renditura më poshtë:

H.Rushiti (1999) në mostrën e 205 të rinjëve të trajtuar me 18 variabla antropometrike dhe 11 motorike me metodën e komponentëve krzesore ka fituar 2 faktorë antropometrik dhe 3 faktorë motorik, me ç'rast ka fituar relacione të rëndësishme të faktorit të gjatësisë dhe testet e forcës eksplozive.

K.Hoxha dhe Z.Cikuli (1995) në studimin e tyre mbi disa të dhëna antropometrike tek fëmijët e Tiranës në moshën 11-14 vjeçare, ku për shqyrtim kanë marrë 16 submostra meshkuj dhe femra dhe kanë aplikuar një bateri prej 7 instrumentëve matëse për vlerësimin e aftësive primare motorike dhe funksionale.

Autorët Matikoshi, Markoviç M, Prot F dhe Findak V. (1990) në mostrën prej 1389 të rinjëve të moshës 11-18 vjeçare të ndarë në 16 submostra meshkuj dhe femra kanë aplikuar baterinë prej 7 instrumentëve matëse për vlerësimin e aftësive primare motorike dhe funksionale.

H.Rushiti (1997) me qëllim të vërtetimit të ndryshimeve në relacionet e zhvillimit të disa aftësive motorike të nxënësve në kushte të ndryshme të punës në mostrën prej 64 nxënësve të qytetit dhe fshatit të testuar në 7 instrumente matëse motorike, ka vërtetuar ndryshime të vlefshme ndërmjet dy grupeve.

Gjinolli E. (1982) ka publikuar hulumtimin “Ndikimi i programeve të ndryshme të procesit mësimor të edukimit fizik në disa dimensione të statusit psikosomatik të nxënësve të klasës së pestë të shkollës fillore”. Qëllimi kryesorë i hulumtimit ka qenë përcaktimi i disa dimensioneve antropometrike dhe motorike të nxënësve të klasëve të pesta të shkollave fillore të Shkupit dhe Gjilanit, që kanë mundur të paraqiten nën ndikimin e programeve jo të harmonizuara të edukimit fizik në ato shkolla. Mostra e etniteteve ka përfshirë 150 nxënës të Shkupit dhe 150 nga Gjilani. Janë aplikuar 3 teste të hapësirës antropometrike dhe 7 ndryshore të hapësirës motorike, me qëllim të krahasimit të rezultateve janë bërë dy matje gjatë vitit shkollor.

Me analizën e rezultateve të fituara në fillim të vitit shkollor 1977/78 dhe në mbarim të vitit shkollor ndryshimet antropometrike dhe motorike kanë qenë në favor të nxënësve nga Shkupi.

Sokoli B (2003) ka hulumtuar hapësirën antropometrike, motorike dhe funksionale të 78 futbollistëve të ligës së parë dhe 80 futbollistë të ligës së dytë të moshës 18-35 vjeçare.

Në bazë të këtij hulumtimi autori vjen në përfundim se treguesit antropometrikë kanë ndikim të caktuar në parashikimin e rezultateve në shumicën e ndryshoreve motorike dhe funksionale andaj parametrat antropometrik duhet të merren parasysh me rastin e seleksionimit të futbollistëve të rinj.

Gabrielič M. (1972) “Disa aftësi psikomotorike situacionale, potenciale dhe aktuale të rëndësishme për suksesin e fëmijëve në lojën e futbollit”. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar nivel të kënaqshëm të prediksonit të suksesit në lojë me ndihmën e testeve të aplikuara.

2. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Objekt studimi në këtë punim do të jetë vlerësimi i rritjes dhe zhvillimit biologjik të dy grupeve të testuar, atyre në shkolla dhe atyre në klube të futbollit.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është:

- Do të vlerësohet gjendja initiale e parametrave antropometrike te të dy grupet testuese (atyre në klube sportive si dhe atyre në shkolla), entitetët do të jenë të moshës 12-13 vjeç (± 6 muaj).
- Do të vlerësohet gjendja initiale e parametrave motorike te të dy grupet testuese (atyre në klube sportive si dhe atyre në shkolla), entitetët do të jenë të moshës 12-13 vjeç (± 6 muaj).
- Të vërehet ndikimi i tretmanit kineziologjik në parametrat antropometrik dhe motorik te të dy grupet që do të testohen (nxënësit që aktivitet primar fizik kanë dy orë të edukimit fizik nga planprogrami arsimor dhe grupi i nxënësve, që aktivisht stërviten në klube futbollistike 3 deri në 4 herë në javë dhe dy orë të rregullta të edukimit fizik në kuadër të planprogramit shkollor që ata kanë në procesin arsimor).
- Do të pasqyrohen dallimet ndërmjet grupeve në hapsirën antropometrike dhe motorike.

Qëllimet tjera në këtë hulumtim do të jenë:

Pasqyrimi i korelacioneve në hapsirën antropometrike,

Pasqyrimi i korelacioneve në hapsirën motorike si dhe

Pasqyrimi i korelacioneve në hapsirën antropometrike dhe motorike.

2.1 HIPOTEZAT THEMELORE

Në këtë punim janë parashtruar këto hipoteza:

Hipoteza 1. Pritet që ndryshoret antropometrike dhe motorike të ken shpërndarje normale të rezultateve.

Hipoteza 2. Pritet të arrihen ndërlidhje të rëndësishme në të dy nivelet e rëndësisë statistikore në hapsirën antropometrike.

Hipoteza 3. Pritet të arrihen ndërlidhje të rëndësishme në të dy nivelet e rëndësisë statistikore në hapsirën motorike.

Hipotezat 4. Supozojmë të ketë dallime të theksuara në parametrat motorike ndërmjet dy grupeve.

3. METODAT E HULUMTIMIT

3.1 PËRKUFIZIMI DHE PËRSHKRIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT

Në grupin e parë është përfshirë mostra e entitetëve të dy shkollave fillore të mesme të ulëta: SHFMU “Bajram Curri”Krushë e Madhe (44 nxënës) dhe SHFMU “Loyola Gymnasium”Prizren (43 nxënës). Nxënësit janë që të gjithë të gjinisë mashkullore të grupmoshës 12-13 vjeç (\pm 6 muaj).

Në grupin e dytë do të përfshihet mostra e entitetëve të përbëra prej dy shkollave të futbollit SHF “Liria” Prizren (43 futbollistë) dhe SHF “Ballkani” Suharekë (43 futbollist). Futbollistët janë të gjithë të gjinisë mashkullore të grupmoshës 12-13 vjeç (\pm 6 muaj).

Të gjithë të testuarit u janë nënshtruar 7 testeve antropometrike dhe 7 testeve motorike.

Matjet antropometrike janë organizuar dhe bërë kryesisht paradite duke filluar nga ora 08:00 – 10:00.

Matjet motorike janë bërë kryesisht pas dite duke filluar nga ora 13:00 – 15:00.

Është me rëndësi të cekim se që të gjithë të testuarve u janë shpjeguar në mënyrë verbale të gjitha testet si dhe të gjitha testet janë demonstruar nga ana e testuesve. Gjithashtu për teste të caktuara motorike të testuarit kanë patur të drejtën e përsëritjes së të njëjtit test tri herë radhazi, ku rezultati më i mirë i tyre është shënuar në kartelën hulumtuese.

3.2 PËRKUFIZIMI DHE PËRSHKRIMI I MOSTRËS SË NDRYSHOREVE

3.2.1 Ndryshoret antropometrike:

- Pesha trupore – APESHA
- Lartësia trupore – ALARTR
- Perimetri i krahut – APEKRA
- Perimetri i krahrorit – APEKRH
- Perimetri i barkut – APERBA
- Perimetri i kofshës – APEKOF
- Perimetri i kërcirit – APEKRC

3.2.2 Ndryshoret motorike:

- Kërcimi nga vendi në gjatësi - MKVGJA
- Kërcimi nga vendi në lartësi – MKVLAR
- Muskuj të barkut – MMUSBA
- Hudhja e medicinbollit nga gjoksi – MHMBGJ
- Vrapim 20 m nga starti i lartë – MVR20M
- Vrapim 60 m nga starti i lartë – MVR60M
- Vrapim 5 x 10 m vajtje-ardhje – MV5X10

3.3 PËRSHKRIMI I TESTËVE ANTROPOMETRIME DHE MOTORIKE

3.3.1 Matjet e testëve antropometrike

1. Matja e peshës trupore – APESHA :

Pesha trupore është matur me peshore Antropometrike (Foto.1), e cila peshore mundësonë saktësinë e matjes prej 0.1 kg, para matjes treguesit njësor duhet rregulluar në pozitën zero. E domosdoshme është që para se i testuari të vendoset mbi të ajo të jetë e pozicionuar në pozicion horizontal në raport me vendosjen e saj në dysheme si dhe të sigurohem që bazamenti ku është vendosur të jetë i fortë. Para se të vihët në peshore i eksperimentuari (i testuari) duhet t’ju përmbahet këtyre rregullave: Ti këtë zbatuar atletët, të jetë në brekë të shkurtra, të qëndroj i qetë mbi peshore në drejt qëndrim dhe të jetë i vendosur në mesin e saj. Pasi të qetësohet treguesi (njesori) elektronik i peshorës atëherë bëhet leximi i rezultatit. Leximi i rezultatit duhet të bëhet me saktësi 0.1 kg⁸. Në fund të dhënave të arritura për secilin entitet janë evidentuar në kartelën evidentuese të hulumtimit.



Foto:1. Matja e peshës trupore

⁸ Agrom M Rexhepi. 2009 "Mjekësia Sportive", (QMRS), fq. 154.

2. Matja e lartësisë trupore – ALARTR :

Lartësia trupore është matur me Antropometër (Foto.2), i cili mundësonë saktësinë e matjes prej në 0.1 cm. Entiteti që matet duhet t'ju përmbahet këtyre rregullave: Atletët duhet ti ketë të zbhatura, të jetë në brekë të shkurtra, të qëndroj i qetë në drejtpëndrim mbi peshore, ku edhe është i vendosur Antropometri. Koka e tij duhet të jetë në atë pozitë që skaji i poshtëm i syrit dhe skaji epërm i vrimës së jashtme të veshit të jenë në pozicion horizontal (Horizontalja e Frankfurtit). Qëndrimi i trupit të entitetit duhet të jetë i relaksuar dhe i drejtë, shputat me thembra të bashkuara dhe me maje të hapura në form shkronjës V, kurse duart e takuara për kofsha. Matësi duhet të qëndroj në anën e majtë të entitetit për ta lexuar rezultatin e lartësisë trupore. Pasi që bën kontrollimin e pozicionit të entitetit dhe të instrumentit (Antropometrit), e lëshon krahun horizontal të Antropometrit deri në pjesën parietale të kokës (Pika më e lartë e kokës – vertex). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm. Në fund të dhënat e arritura për secilin entitet janë evidentuar në kartelën evidentuese të hulumtimit.



Foto:2.Matja e lartësisë trupore

3. Matja e perimetrit të krahut – APEKRA :

Perimetri i krahut është matur me shirit centimetrik (Foto.3).Entiteti i testuar në këtë test duhet të marrë një pozicion i vendosur në drejt qëndrim, me këmbë të hapura sa gjerësia trupore,duart duhet ti largoj pak nga trupi në mënyrë që të ketë mundësi lëvizje me shiritin metrik,frymëmarrjen ta ketë të qetë dhe të jetë i relaksuar.Shiriti vendosët në 1/3 e sipërme të krahut (në gjerësinë më të madhe të tij).Rezultati i matjes lexohet me saktësia 0.1 cm. Në fund të dhënat e arritura për secilin entitet janë evidentuar në kartelën evidentuese të hulumtimit.



Foto 3. Matja e perimetrit të krahut

4. Matja e perimetrit të krahrorit – APEKRH :

Perimetri i krahrorit është matur me shirit centimetrik (Foto.4).Entiteti i testuar në këtë test duhet të marrë një pozicion i vendosur në drejt qëndrim me këmbë të hapura sa gjerësia trupore,duart duhet ti ketë diçka më të larguara nga trupi në mënyrë që të ketë mundësi lëvizje me shiritin metrik, frymëmarrja në fillim të jetë e qetë dhe të jetë i relaksuar,kurse në fund të kemi frymëxjerrje të theksuar.Shiriti pa bërë presion të madh në lëkurë vendosët në lartësi të mamillave në mënyrë horizontale duke tërhekur me të dy duart në drejtime të kundërta.Perimetri i krahrorit matët në fund të fazës së frymëxjerrjës (ekspirimit).Rezultati i matjës lexohet me saktësia 0.1 cm. Në fund të dhënat e arritura për secilin entitet janë evidentuar në kartelën evidentuese të hulumtimit.



Foto:4.Matja e perimetrit të krahrorit

5. Matja e perimetrit të barkut – APEBAR :

Perimetri i barkut është matur me shirit centimetrik (Foto.5). Entiteti i testuar në këtë test duhet të marrë një pozicion i vendosur në drejt qëndrim me këmbë të hapura sa gjerësia trupore,duart duhet ti ketë diçka më të larguara nga trupi në mënyr që të kemi mundësi lëvizje me shiritin metrik, frymëmarrja të jetë në një thellësi mesatare. Shiriti pa bërë presion të madh në lëkurë vendosët mbi kërthizë në mënyrë horizontale duke tërhekur me të dy duart në drejtime të kundërta. Rezultati i matjes lexohet me saktësi 0.1 cm. Në fund të dhënat e arritura për secilin entitet janë evidentuar në kartelën evidentuese të hulumtimit.



Foto:5.Matja e perimetrit të barkut

6. Matja e perimetrit të kofshës – APEKOF :

Perimetri i kofshës është matur me shirit centimetrik (Foto.6).Entiteti i testuar në këtë test duhet të marrë një pozicion i vendosur në drejt qëndrim me këmbë të hapura sa gjerësia trupore,por me peshë trupore të shpërndarë në mënyrë simetrike në të dy këmbët,duart duhet ti ketë diçka më të larguara nga trupi në mënyrë që të kemi mundësi lëvizje me shiritin metrik,frymëmarrja të jetë e qetë dhe i relaksuar.Shiriti pa bërë presion të madh në lëkurë vendoset horizontalisht rreth kofshës së majtë nën lugun gluteal në vendin më të gjerë të kofshës dhe tërhekët me të dy duart në drejtime të kundërta. Rezultati i matjes lexohet me saktësinë 0.1 cm. Në fund të dhënat e arritura për secilin entitet janë evidentuar në kartelën evidentuese të hulumtimit.



Foto:6.Matja e perimetrit të kofshës

7. Matja e perimetrit të kërcirit – APEKRC :

Perimetri i kërcirit është matur me shirit centimetrik (Foto.7).Entiteti i testuar në këtë test duhet të marrë një pozicion i vendosur në drejt qëndrim me këmbë të hapura sa gjerësia trupore,por me peshë trupore të shpërndarë në mënyrë simetrike në të dy këmbët,duart duhet ti ketë diçka më të larguara nga trupi në mënyrë që të kemi mundësi lëvizje me shiritin metrik,frymëmarrja të jetë e qetë dhe i relaksuar.Shiriti pa bërë presion të madhë në lëkurë vendosët horizontalisht rrethë kërcirit të këmbës së majtë apo në 1/3 e sipërme të kërcirit respektivisht në pjesën më të gjerë të saj dhe shiriti metrik tërhekët me të dy duart në drejtime të kundërta. Rezultati i matjes lexohet me saktësinë 0.1 cm. Në fund të dhënat e arritura për secilin entitet janë evidentuar në kartelën evidentuese të hulumtimit.



Foto:7.Matja e perimetrit të kërcirit

3.3.2 Matjet e testëve motorike

1. Kërcimi nga vendi në gjatësi – MKVGJA :

1.Qëllimi i testit: Me këtë test masim forcën eksplozive të gjymtyrëve të poshtme.

2.Vendi i realizimit dhe rekuizitat:Pasi që testet janë matur në dy popullacione në shkolla dhe në klube, atëherë është dashur t'ju përshtatemi kushteve që kemi zotëruar ,ku në shkolla testi është mbajtur në palestër kurse në klube në fusha të futbollit të mbuluara me bari sintetik.Për ta bërë më të lehtë matjen në podë kemi vendosur horizontalisht një shirit metrik të gjatësisë 300 cm. (Foto.8.a,b).

3.Përshkrimi i detyrës:3.1.Pozicioni fillestar:Entiteti vendosët para vijës së kërcimit me shputa paralel njëra me tjetrën ,me fytyrë kah drejtimi i kërcimit.3.2.Realizimi i detyrës:Entiteti me përkulje të lehtë në gjunjë duke përfutur nga hovi i krahëve,realizon kërcimin me të dy këmbët para.Detyra përsëritët tre herë,ndërsa në kartelën hulumtuese evidentohet rezultati më i mirë i tij.4.Udhëzimi i të testuarit:Detyra në testim duhet shpjegohet,ilustrohët dhe në fund bëhet demonstrimi i detyrës.Kërcimi përsëritët nëse i testuari bënë para kërcim të vogël para se ta bëjë kërcimin para,nëse kërcimi realizohët në një këmbë,nëse pas rënjes mbështetët prapa me duar apo ndonjë pjese tjetër trupore.5.Vlerësimi i testit:Shënohet rezultati i kërcimit më të gjatë nga vija e kërcimit deri tek gjurmët e pjesës së prapme të shputave me saktësi metrike 1 cm.




Foto:8.a),b).Matja e kërcimit nga vendi në gjatësi

2. Kërcimi nga vendi në lartësi – MKVLAR :

1.Qëllimi i testit: Me këtë test masim forcën eksplozive të gjymtyrëve të poshtme.

2.Vendi i realizimit dhe rekuizitat:Pasi që testet janë matur në dy popullacione në shkolla dhe në klube atëherë është dashur t’ju përshtatemi kushteve që kemi zotëruar ,ku në shkolla testi është mbajtur në palestër, kurse në klube në fusha të futbollit të mbuluara me bari sintetik.Për ta bërë më të lehtë matjën në shtyllat vertikale të portave kemi vendosur një metër druri me një gjatësi 300 cm. (Foto.9.a,b).

3.Përshkrimi i detyrës:

3.1.Pozicioni fillestar:Entiteti vendosët afër shtyllës vertikale brinjazi ku është vendosur metri vertikal në shtyllë,me krahun e djathtë të ngritur lartë dhe të shtrirë plotësisht dhe me gishtin e mesëm të shuplakës i cili është më i gjati takon pikën më të lartë të metrit.Në këto momente matësi shënon lartësinë e prekjes së gishtit në metër nga pozicioni statik i entitetit pa kërcyer fare.

3.2.Realizimi i detyrës:Entiteti shkëputët vertikalisht nga toka me të dy këmbët duke takuar metrin e vendosur në shtylla në pikën më të lartë maksimale.Detyra përsëritet tre herë,ndërsa në kartelën hulumtuese evidentohet rezultati më i mirë i tij.

4.Udhëzimi i të testuarit:Detyra në testim duhet shpjegohet,ilustrohet dhe në fund bëhet demonstrimi i detyrës.Gjatë matjes së lartësisë së parë në gjendje qetësie,krahu i djathtë duhet të jetë i shtrirë plotësisht,kërcimi të realizohet me të dy këmbët,gjatë kërcimit trupi mos të kthehet me ballë kah metri, por trupi në raport me metrin të jetë brinjazi.5.Vlerësimi i testit:Shënohet rezultati i kërcimit më të mirë pas ndryshimit të bërë ndërmjet lartësisë me krahë të shtrirë dhe lartësisë pas kërcimit ,me saktësi metrike 1 cm.



Foto:9.a),b,c).Matja e kërcimit nga vendi në lartësi

3. Ngritja e trupit para (muskujt e barkut) – MMUSBA :

1.Qëllimi i testit: Me këtë test masim forcën repetitive (dinamike) të trupit apo muskujve abdominal.

2.Vendi i realizimit dhe rekuizitat:Pasi që testet janë matur në dy popullacione në shkolla dhe në klube atëherë është dashur t’ju përshtatemi kushteve që kemi zotëruar ,ku në shkolla testi është mbajtur në palestër, kurse në klube në fusha të futbollit të mbuluara me bari sintetik.Për ta bërë më të lehtë matjën në pod kemi vendosur një sungjer gjimnastikor me përmas 2 x 1 m. (Foto.10.a,b,c).

3.Përshkrimi i detyrës: 3.1.Pozicioni fillestar: Entiteti vendoset shtrirë shpinazi horizontalisht në sungjer me duar të kryqëzuara mbrapa kokës,gjunjët duhet ti mbledhë deri sa fomon këndin 15 shkallë ndërmjet kërcirit dhe kofshave.Për ta pasur më lehtë ekzekutimin e këtij testi, i testuari asistohet nga një shok i tij duke ja mbajtur shputat me duar apo gjunjë për të mos pasur lëvizje në shputa. 3.2.Realizimi i detyrës:Entiteti brenda kohës 30 sekonda duhet me trup të mbledhët në drejtim të gjunjëve duke bërë përsëritje maksimale që mundët.

4.Udhëzimi i të testuarit:Detyra në testim duhet shpjegohet,ilustrohet dhe në fund bëhet demonstrimi i detyrës.Gjatë matjes këtij testi i testuari duhet të ngritet deri sa me bërryla takon gjunjët e tij,tek kthimi në pozicionin fillestar nuk lejohet të ketë ngritje të abdomenit lartë për të krijuar inercion.Një përsëritje konsiderohet e plotë kur i testuari nga pozicioni fillestar ngritet deri sa me brryla takon gjunjët dhe përsëri kthehet në pozicion fillestar duke pasur shpinën plotësisht të shtrirë në sungjerin gjimnastikor.

5. Vlerësimi i testit:Shënohet numri maskimal i ngritjëve brenda kohes prej 30 sekondave.



Foto:10.a),b),c).Ngritja e trupit para (muskujt e barkut)

4. Hudhja e medicinbollit nga gjoksi – MHMBGJ :

1.Qëllimi i testit: Me këtë test masim forcën eksplozive të krahëve.

2.Vendi i realizimit dhe rekuizitat:Pasi që testet janë matur në dy popullacione në shkolla dhe në klube, atëherë është dashur t’ju përshtatemi kushtëve që kemi zotëruar ,ku në shkolla testi është mbajtur në palestër kurse në klube në fusha të futbollit të mbuluara me bari sintetik.Për ta bërë më të lehtë matjen është dashur të përdorim këto mjete:Medicinbollin 2 kg,një ulëse,shiritin metrik 600 cm (Foto.11.a,b).3.Përshkrimi i detyrës:3.1.Pozicioni fillestar: I testuari vendosët i ulur në ulëse me shputa paralel me vijën ku është vendosur fillimi i njesorit metrik,trupi duhet të jetë vertikalisht në raport me ulësën dhe shpina duhet të ketë mbështetjë të plotë në mbështetësen e ulësës,topi medicin i kapur anash me dy duar duhet të jetë afër trupit,kurse shikimi të jetë para nga vendi ku duhet të bëhet hedhja e topit.3.2.Realizimi i detyrës:Nga pozicioni i përshkruar më lartë i testuari me forcën maksimale që mundet hedh topin para deri sa krahët ti ketë shtrir dhe larguar plotësisht nga trupi. Detyra përsëritet tre herë,ndërsa në kartelën hulumtuese evidentohet rezultati më i mirë i tij.4.Udhëzimi i të testuarit:Detyra në testim duhet shpjegohet,ilustrohët dhe në fund bëhet demonstrimi i detyrës.Gjatë hedhjes së topit i testuari nuk ka të drejtë të ketë lëvizje të pjesëve të ndryshme të trupit,sidomos pjesa e trungut nuk duhet të largohet nga mbështetësja e ulësës.5.Vlerësimi i testit:Rezultati i detyrës është largësia e hedhjes së topit (shënohet rezultati më i mirë i hedhjes),me saktësi metrike 1 cm⁹.



a)



b)

Foto:11.a),b).Matja e hudhjes së medicinbollit nga gjoksi

⁹ Hasim Rushiti “ Testimet dhe Përshkrimi i Ushtrimit Fizik “ (Program i Studimeve Master),fq.27.

5. Vrapimi 20 m nga starti i lartë – MVR20M :

1.Qëllimi i testit: Me këtë test masim shpejtësinë e nisjes në distanc 20 m.

2.Vendi i realizimit dhe rekuizitat: Pasi që testet janë matur në dy popullacione në shkolla dhe në klube atëherë është dashur t’ju përshtatemi kushtëve që kem zotëruar ,ku në shkolla testi është mbajtur në palestër kurse në klube në fusha të futbollit të mbuluara me bari sintetik. Për ta bërë më të lehtë matjen është dashur të përdorim këto mjete:Kronometrin,pengesat për shenjëzimin e kursisë së vrapimit si dhe izolirët e letres për vijëzimin e distancës ku bëhet nisja dhe mbraimi i vrapimit. Po ashtu në këtë test kanë marrë pjesë dy matës njëri qëndron tek vija e nisjes dhe sinjalizon të testuarin për nisje me komandat “ GATI “,”TASH “, kurse tjetri qëndron tek caku dhe mat kohën e mbërritjes. Distanca e vrapimit në këtë test nga starti deri në finish është 20 m (Foto.12.a,b).

3. Përshkrimi i detyrës:3.1.Pozicioni fillestar: I testuari vendoset para vijës së nisjes në pozicionin e startit të lartë.3.2. Realizimi i detyrës:Nga pozicioni i përshkruar më lartë i testuari pas komandës “GATI” nga matësi ndihmës me komandën “TASH”,vrapon me shpejtësi maksimale distancën prej 20 m.Në kartelën hulumtuese evidentohet rezultati më i mirë i tij.4. Udhëzimi i të testuarit: Detyra në testim duhet shpjegohet,ilustrohet dhe në fund bëhet demonstrimi i detyrës. Në rast starti jo të rregullt vrapimi përsëritet, i testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke bërë ndalje graduale.5. Vlerësimi i testit:Matet koha nga dhënja e sinjalit nga matësi ndihmës,deri në momentin kur i testuari kalon me trup vijën e cakut. Rezultati lexohet me saktësi metrike 0.1 sekondë.




Figura: 12.a),b).Matja e vrapimit në shpejtësi 20 m

6. Vrapimi 60 m nga starti i lartë – MVR60M :

1.Qëllimi i testit: Me këtë test masim shpejtësinë e nisjes në distanc 60 m.

2.Vendi i realizimit dhe rekuizitat:Pasi që testet janë matur në dy popullacione në shkolla dhe në klube, atëherë është dashur t'ju përshtatemi kushtëve që kemi zotëruar, ku në shkolla testi është mbajtur në palestër kurse në klube në fusha të futbollit të mbuluara me bari sintetik. Për ta bërë më të lehtë matjen është dashur të përdorim këto mjete: Kronometrin, pengesat për shenjzimin e kursisë së vrapimit si dhe izolirët e letres për vijëzimin e distancës ku bëhet nisja dhe mbraimi i vrapimit.Po ashtu në këtë test kanë marrë pjesë dy matës njëri qëndron tek vija e nisjes dhe sinjalizon të testuarin për nisje me komandat “ GATI “,”TASH “, kurse tjetri qëndron tek caku dhe matë kohën e mbërritjes.Distanca e vrapimit në këtë test nga starti deri në finish është 60 m (Foto.13.a,b).

3.Përshkrimi i detyrës:3.1.Pozicioni fillestar: I testuari vendosët para vijës së nisjes në pozicionin e startit të lartë.3.2.Realizimi i detyrës:Nga pozicioni i përshkruar më lartë i testuari pas komandës “GATI” nga matësi ndihmës me komandën “TASH”,vrapon me shpejtësi maksimale distancën prej 60 m.Në kartelën hulumtuese evidentohet rezultati më i mirë i tij.4.Udhëzimi i të testuarit:Detyra në testim duhet shpjegohet,ilustrohet dhe në fund bëhet demonstrimi i detyrës.Në rast starti jo të rregullt vrapimi përsëritet, i testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke bërë ndalje graduale.5.Vlerësimi i testit:Matet koha nga dhënja e sinjalit nga matësi ndihmës,deri në momentin kur i testuari kalon me trup vijën e cakut. Rezultati lexohet me saktësi metrike 0.1 sekondë.




Foto:13.a),b).Matja e vrapimit në shpejtësi 60 m

7. Vrapimi 5 x 10 m vajtje-ardhje – MV5X10:

1.Qëllimi i testit: Me këtë test është vlerësuar shpejtësia maksimale e vrapimit me ndërrim të drejtimit.

2.Vendi i realizimit dhe rekuizitat:Pasi që testet janë matur në dy popullacione në shkolla dhe në klube, atëherë është dashur t’ju përshtatemi kushtëve që kemi zotëruar ,ku në shkolla testi është mbajtur në palestër kurse në klube në fusha të futbollit të mbuluara me bari sintetik.Për ta bërë më të lehtë matjen është dashur të përdorim këto mjete:Kronometrën,pengesat për shenjzimin e kursisë së vrapimit si dhe izolirët e letrës për vijëzimin e distancës ku bëhet nisja dhe mbraimi i vrapimit. (Foto.14.a,b,c).

3.Përshkrimi i detyrës:3.1.Pozicioni fillestar: I testuari vendosët para vijes së nisjes në pozicionin e startit të lartë.3.2.Realizimi i detyrës: Nga pozicioni i përshkruar më lartë i testuari pas komandës “GATI” nga matësi me sinjal të nisjes i testuari me shpejtësi maksimale kalon distancën prej 5 m duke kaluar ndërmjet dy konave që në mesë kanë vijëzimin ,pastaj kthehet me vrapim deri në mes të dy konave ku e ka bërë nisjen fillestare dhe përfundon një cikël vrapimi.Këtë detyrë i testuari e përsërit pesë herë (pra një cikël përfshin vrapimin 2 x 5 m vajtje ardhje),pa bërë ndërprerje ndërmjet cikleve. Në kartelën hulumtuese evidentohet rezultati më i mirë i tij.4.Udhëzimi i të testuarit:Detyra në testim duhet shpjegohet,ilustrohet dhe në fund bëhet demonstrimi i detyrës.Në fillim i testuari udhëzohet që ta bëjë një realizim në tërësi të detyrës në formë të provës duke përfshi vetëm një cikël 2 x 5 m,në rast starti jo të rregullt vrapimi përsëritet,vrapimi të jetë me kahje të drejtë.5.Vlerësimi i testit:Matet koha nga dhënja e sinjalit nga matësi ndihmës,deri në momentin kur i testuari kalon me trup vijën e caktuar pas përfundimit ciklit pestë.Rezultati lexohet me saktësi metrike 0.1 sekondë.



Foto: 14.a),b),c).Matja e vrapimit në shpejtësi 5 x 10 m

4. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara janë përdorur metodat e përpunimit të rezultateve të cilat kanë siguruar informacione të mjaftueshme për ta realizuar këtë qëllim hulumtues.

Për çdo ndryshore antropometrike dhe motorike janë llogaritur parametrat themelor statistikor:

- Mesatarja aritmetikore (MA)
- Devijimi standard (DS)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)
- Masat e asimetrisë (skewness dhe kurtosis)
- Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshorëve antropometrike dhe motorike janë bërë përmes analizes së korelacionit sipas Pearsonit.
- T-testit
- Analiza Diskriminative

5. REZULTATET DHE INTERPRETIMI I TYRE

5.1 PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR TË GRUPIT TË NXËNËSVE TË KLUBEVE

Në tabelën 1, janë dhënë rezultatet nga parametrat themelor statistikor, me ç'rast janë llogaritur: rezultati minimal, rezultati maksimal, mesi aritmetik, devijimi standard¹⁰ si dhe masat e asimetrisë skewness dhe kurtosis të grupit të nxënësve të klubeve.

